



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe neneve 7, 8, 9, 10 dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) si dhe neneve 12, 20 dhe 29.2 të Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 03/2023**  
**KRIJIMI, KONFIRMIMI DHE KUNDËRSHTIMI I LISTËS SË VOTUESVE**

**Neni 1**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përcakton procesin e kundërshtimit dhe konfirmimit, publikimin e Listës së Votuesve (LV) dhe shpërndarjen, si dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë këtij procesi.

**Neni 2**  
**Procesi i krijimit të listës së votuesve**

1. KQZ krijon LV dhe siguron që ajo të jetë e saktë, e përditësuar dhe përmban:
  - 1.1. Ekstraktin e fundit në dispozicion nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile (RQGJC) i të gjithë shtetasve me të drejtë vote, të cilët janë regjistruar si qytetarë të Republikës së Kosovës sipas Ligjit Nr. 04/l-215 për Shtetësinë e Kosovës;
  - 1.2. të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës, të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.
2. Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) pajisë KQZ me të gjitha informatat përkatëse që kërkohen për të mirëmbajtur LV, në pajtim me afatet kohore të caktuara.
3. Me qëllim të krijimit të LV, KQZ gjatë procesit zgjedhor pranon tri (3) herë ekstraktin e RQC nga ARC. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV.

4. Në vitet jo zgjedhore, KQZ do të kërkojë nga ARC dy herë në vit ekstraktin me të dhënat e shtetasve me të drejtë vote, me qëllim të përpunimit dhe publikimit në platformën online për ndërrimin e Qendrës së Votimit (QV) në ueb faqe.
5. Ekstrakti i RQC duhet të përmbajë të gjithë qytetarët e regjistruar të moshës mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe ata që i mbushin 18 vjet në ditën e zgjedhjeve.
  - 5.1. Informatat personale që do të sigurohen për secilin qytetar janë: emri, mbiemri, data e lindjes, gjinia, emri i njërit prind, numri personal, data e regjistrimit civil, komuna, qendra komunale e regjistrimit civil, kodi i komunës, emri i vendbanimit, adresa, Kodi i vendbanimit urban (UD-kodi) dhe Kodin e vendbanimit (P-kodi).
6. KQZ, jo më vonë se dhjetë (10) ditë para se të fillojë periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të LV, duhet të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të dorëzojë listën e personave të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor. Të dhënat personale të këtyre personave duhet të përfshijnë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe adresën.
7. KQZ, para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV, do t'i largojë nga LV emrat e personave që me vendim gjyqësor të formës së prerë u është marrë zotësia e veprimit.
8. LV do të përmbajë:
  - 8.1. Të gjithë qytetarët me të drejtë vote që votojnë në Kosovë, të renditur sipas komunës dhe alfabetit. Informatat personale që do të sigurohen për secilin votues janë: mbiemri, emri, data e lindjes, numri personal, adresa dhe QV ku ai/ajo është caktuar të votojë;
  - 8.2. të gjithë votuesit me zotësi juridike që votojnë jashtë Kosovës, të renditur sipas shtetit ku kanë vendbanimin, sipas komunës në Kosovë dhe alfabetit. Informatat personale që do të sigurohen për secilin votues janë: mbiemri, emri, data e lindjes së tij/saj, numri personal, vendbanimin jashtë Kosovës dhe komunën në Kosovë.
9. Me periudhën e kundërshtimit dhe të konfirmimit nënkuptohet periudha kohore në mes 54 ditëve dhe 40 ditëve para ditës së zgjedhjeve, e shpallur nga Presidenti i Kosovës, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë dhe lëshimet në LV, në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë Rregullore dhe të gjitha dispozitat ligjore në zbatim.
10. Para se të fillojë periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit, KQZ do të vë LV në dispozicion në zyrat e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në secilën komunë. KKZ mund të caktojë lokacion shtesë për ta vendosur LV, kur është e nevojshme për t'u dhënë votuesve më shumë mundësi që të kenë qasje në LV në komunën e tyre, në përputhje me Ligjin Nr. 06/l-082 për Mbrojtjen e të dhënave personale.

11. LV që është vënë në dispozicion të publikut, subjekteve politike të certifikuara dhe vëzhguesve të akredituar, gjatë periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit, nuk duhet të përmbajë numrat personalë të votuesve.
12. Para ditës së zgjedhjeve, KQZ do ta certifikojë LV e cila është krijuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi që publiku ka pasur mundësi t'i sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë.

### **Neni 3**

#### **Procesi i kundërshtimit dhe konfirmimit**

1. Çdo votues me zotësi juridike, siç është specifikuar në nenin 5 të LZP, mund të ketë qasje dhe të sfidojë LV, ose çdo pasaktësi ose mangësi në LV, gjatë periudhës së kundërshtimit dhe të konfirmimit, çdo ditë pune nga e hëna deri të premtën, prej orës 09:00 deri 12:00 dhe prej orës 13:00 deri 16:00, në hapësirat e KKZ, në secilën komunë.
2. Vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve, mund të vëzhgojnë periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit në të gjitha lokacionet ku LV është vënë në dispozicion për shikim.
3. Çdo votues me zotësi juridike, mund të shqyrtojë ose të sfidojë LV, ashtu siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, me kusht që ai/ajo të identifikohet siç duhet para KKZ, duke paraqitur njërin nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:
  - 3.1. Letërnjoftimin e vlefshëm;
  - 3.2. pasaportën e vlefshme;
  - 3.3. patentë shoferin e vlefshëm.
4. Çdo votues me zotësi juridike i regjistruar suksesshëm për votim jashtë Kosovës, mund ta shqyrtojë LV, në ueb-faqen zyrtare të KQZ, siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni. Votuesi i regjistruar suksesshëm për votimin jashtë Kosovës mund ta sfidojë LV, duke identifikuar në mënyrë të rregullt veten, me njërin nga dokumentet e identifikimit që pasojnë:
  - 4.1. Dokumentin valid me foto;
  - 4.2. dëftesën e regjistrimit si votues jashtë Kosovës.
5. Një person, i cili e identifikon veten me një dokument identifikimi siç parashihet në paragrafin 3 dhe paragrafin 4 të këtij neni, mund të kërkojë korrigjim ligjor në gjykatën e shkallës së parë, në pajtim me LZP, nëse ai/ajo konstaton se emri i tij/saj nuk gjendet në LV.

6. Personi që dëshiron të kundërshtojë një emër, për të cilin ai/ajo mendon se nuk duhet të jetë në LV, mund të kërkojë korrigjim ligjor në gjykatën e shkallës së parë, në pajtim me LZP.

#### **Neni 4**

##### **Shpërndarja e kopjeve të listave të votuesve**

1. KQZ i siguron LV çdo personi kontaktues të secilit subjekt politik të certifikuar, para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit.
2. Sipas kërkesës së organizatës së vëzhguese të akredituar të zgjedhjeve, KQZ do të sigurojë kopje të LV, e cila përmban të dhënat e votuesve të listës preliminare të votuesve, që është publikuar për qëllime të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të kësaj liste.
3. Ndalohet çdo keqpërdorim i LV nga subjektet politike të certifikuara dhe vëzhguesit e akredituar.

#### **Neni 5**

##### **Procesi i gjykimit**

Ne rast se personi kërkon korrigjim ligjor në pajtim me nenin 3 paragrafi 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje dhe gjykata e shkallës së parë vendos që kërkesa e personit është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, gjykata e shkallës së parë ka autoritetin për të urdhëruar KQZ veprojë sipas vendimit në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me LV.

#### **Neni 6**

##### **Parimet për mbrojtjen e të dhënave personale**

1. Subjektet politike të certifikuara dhe vëzhguesit e akredituar, do ta shqyrtojnë LV vetëm me qëllim të verifikimit e saktësisë së LV, mund të përcjellin periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit, ndërsa të dhënat nga LV do t'i trajtojnë me konfidencialitet, bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Subjekteve politike të certifikuara dhe vëzhguesve të akredituar, nuk iu lejohe:
  - 2.1. Të krijojnë bazë të të dhënave të votuesve, apo të përdorin LV që të azhurnojnë çfarëdo baze të tyre të të dhënave;
  - 2.2. të bëjnë kopje apo ekstrakt të LV, në kundërshtim me qëllimet nga paragrafit 1 i këtij neni;
  - 2.3. të transferojnë LV apo të dhënat personale nga LV tek palët e treta;
  - 2.4. të shfrytëzojnë LV për fushatë të planifikuara zgjedhore.

3. Vëzhguesve të akredituar nuk iu lejoheq qe:

3.1. T'i asistojnë cilitdo votues apo staf të KKZ në identifikimin e votuesve në LV, apo në përgatitjen e kërkesës për t'ia paraqitur gjykatës së shkallës së parë;

3.2. të kenë qasje në numrin personal të votuesve në LV, e cila përdoret nga KKZ gjatë periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit.

#### **Neni 7**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore Nr.02/2013 krijimi, konfirmimi dhe kundërshtimi i listës së votuesve.
2. KQZ do të hartojë procedurë të veçantë për procesin e krijimit të LV, ku do të përfshihet: mënyra e pajisjes me ekstraktin më të vonë të RQC nga ARC, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, mënyrën e caktimit të votuesve në QV, shpërndarjen dhe publikimin e LV, krijimin dhe shtypjen e Listës përfundimtare të votuesve LPV, dhe shkatërrimin e të dhënave pas procesit zgjedhor.

#### **Neni 8**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**